

VENDIM
Nr.17, datë 14.7.2014

PËR RINOVIM LICENCE NDËRMARRJA UJËSJELLËS KANALIZIME, BASHKIA
PUKË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1.Rinovim licence, për efekt të përfundimit të afatit operatorit Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime, Bashkia Pukë, me:

Drejtues ligjor: Demir Hyseni;
Drejtues teknik: Lindita Hyseni.

2.Operatori Ndërmarrja UJ Bashkia Pukë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3.Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Pukë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare deri më datë 13.7.2018.

KRYETARI
Avni Dervishi